

**MA Bekim ALIU**

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

## **FONDI “GJYQI I QARKUT NË PRIZREN”, DIGJITALIZIM APO RESTAURIM**

**Abstrakt:** *Digjitalizimi ka prezantuar dimensione të reja në ndërveprim mes qasjes dhe ruajtjes së materialeve të trashëgimisë kulturore në arkiva. Konceptet e qasjes dhe ruajtjes janë të lidhura ngushtë, por ndonjëherë mund të jenë në mosmarrëveshje kur gjendja e materialeve origjinale kufizon përdorimin e tyre. Marrëdhënia ndërmjet qasjes dhe ruajtjes është veçanërisht e ngatërruar në rastin kur fondi apo koleksioni arkivor është i brishtë dhe i vështirë për t’u shfrytëzuar por edhe paraqet rrezik për ruajtje. Digjitalizimi ka lehtësuar disa nga tensionet mes dëshirës për të siguruar qasjen dhe nevojën për të mbrojtur dokumentet origjinale.*

*Fondi “Gjyqi i Qarkut në Prizren” është një fond i trashëguar me probleme serioze në ruajtje të dokumenteve origjinale për shkak të rrezikut të lartë të shkatërrimit total nga substancat biologjike dhe kimike.*

*Në këtë rast digjitalizimi ofron një mundësi për të kapur përmbajtjen e dokumenteve të përkeqësuar, për të zgjeruar qasjen në to, dhe për të rivendosur dobinë e tyre si informacion burimor. Digjitalizimi si një strategji ruajtjeje ka qenë objekt i vazhdueshëmdebatit, shih për këtë, ky punim kontribuon në diskutim duke eksploruar qasjen dhe ruajtjen në fonde dhe koleksione arkivore të rrezikuara nga shkatërrimi dhe duke e paraqitur digjitalizimin e projektit në fjalë pranë Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës si një rast studimor.*

**Fjalët kyçe:** *Digjitalizim, ruajtje, qasje, dokumente origjinale, restaurim dhe konservim, rrezik për shkatërrim.*

### **Kufizimet e qasjes**

Fondi “Gjykata e Qarkut në Prizren” paraqet një sfidë të madhe ruajtjeje për shkak të natyrës fizike të paqëndrueshme dhe në shkatërrim e sipër, si rezultat i ruajtjes jo adekuate tek fondkrijuesi. Gjithashtu edhe qasja ndaj dokumenteve që

mban ky fond është e kufizuar dhe e vështirë për mungesëtë indeksimit gjithëpërfshirës dhe pikave të aksesit të standardizuar.

Rregullimi fizik i fondit në fjalë është bërë nga fondkrijuesi. Fondi ka përshkrim të kufizuar tekstual dhe nuk ka të dhëna individuale të indeksimit dhe informata kontekstuale. Në disa raste dokumentet kanë humbur ose janë ndarë nga dosja. Materialet origjinale për shkak të brishtësisë dhe rrezikut nga shkatërrimi janë thelbësisht të vështira për t'u përshkruar dhe qasja për indeksim me tekst është e pamundur.

### **Digjitalizimi si një strategji ruajtëse**

Komuniteti i trashëgimisë kulturore ka diskutuar digjitalizimin si një strategji ruajtje që nga ditët e hershme të projekteve të digjitalizimit. Debatu përqendrohet në tension midis ruajtjes afatgjatë dhe zgjerimit të qasjes. Fillimisht, digjitalizimi u pranua si një formë e kopjimit për qasje më të gjerë dhe më të lehtë, por jo si një metodë për krijimin e kopjeve të cilësisë së ruajtjes së materialeve origjinale. Ndërsa theksoi përfitimet e digjitalizimit në sigurimin e qasjes, Abby Smith argumentoi në të njëjtën kohë se “digjitalizimi nuk është ruajtje, të paktën jo ende.”<sup>1</sup> Disa vjet më vonë, Janet Gertz përsëriti këtë mendim, por gjithashtu vuri në dukje se digjitalizimi mund të ndihmojë në ruajtje duke mbrojtur materialet e brishta dhe të vlefshme analoge nga dëmtimi që sjell përdorimi.<sup>2</sup> Sidoqoftë, propozuesit dhe kundërshtarët e digjitalizimit si metodë ruajtjeje pranojnë se digjitalizimi ndihmon ruajtjen tradicionale dhe përpjekjet e ruajtjes duke zgjeruar qasjen dhe duke reduktuar përdorimin e origjinaleve të brishta.<sup>3</sup>

Shqetësimet rreth përdorimit të digjitalizimit si një opsion për ruajtjen afatgjatë të materialeve analoge përqendrohen në integritetin dhe origjinalitetin e të dhënave digjitale, si dhe në stabilitetin e formateve digjitale dhe të medias ku ato ruhen. Projektet digjitale të konvertimit të ndërmarra sipas standardeve të digjitalizimit, jo vetëm sigurojnë kopje për qasje dhe përdorim të menjëhershëm, por gjithashtu krijojnë një pasuri të re të vlefshme në formën e dosjeve të arkivit të ashtuquajtur “master” që kërkojnë ruajtjen afatgjatë digjitale.<sup>4</sup> Në dallim nga metodat e ruajtjes të përcaktuara si mikrofilmi, fotokopje letre ose dyfishime fotosh, teknologjia digjitale është relativisht e re dhe ngre pyetje rreth qasjes dhe rikthimit të të dhënave të digjitalizuara për shkak të vjetërsimit të mundshëm të

pajisjeve dhe programeve kompjuterike. Në shqyrtimin e sfidave të ruajtjes digjitale, Kenneth Thibodeau vuri në dukje një tension të pandarë ndërmjet “digjitalizimit”, i cili është lëngu polimorfik dhe i paqëndrueshëm, dhe “ruajtja”, e cila përpiqet të mbajë gjërat të pandryshuara.<sup>5</sup>

Mbështetja e digjitalizimit si një strategji e reformatimit me synim ruajtjen e materialeve arkivore nga Shoqata e Bibliotekave Kërkimore (Association of Research Libraries) me seli në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 2004 përfaqësonte një pikë kthese në diskutim.<sup>6</sup> Propozimi njohu konvertimin digjital si një nga opsionet e mundshme për ruajtje dhe vuri në dukje se çdo teknikë e reformatimit të ruajtjes ka forcën dhe dobësitë e veta.

Digjitalizimi si një metodë ruajtje gradualisht është duke u pranuar nga anëtarët e komunitetit të trashëgimisë kulturore. Programi i Arkivave të Rrezikuara në Bibliotekën Britanike (The Endangered Archive Programme (EAP) at the British Library) mbështet digjitalizimin si mjetin e preferuar të kopjimit të materialeve arkivore në rrezik shkatërrimi ose përkeqësimi fizik. Ky rekomandim është veçanërisht i rëndësishëm në vendet në zhvillim ku mund të mos jenë të disponueshme metoda të tjera të ruajtjes, të tilla si mikrofilmi. Edhe kritikët e miratimit të programit në fjalë kanë rekomanduar përdorimin e digjitalizimit si metodë reformatimi kur ajo ofron shansin më të mirë ose të vetëm për ruajtjen e fondeve apo koleksioneve arkivore, që janë të rrezikuara nga shkatërrimi.<sup>7</sup> Njohja e digjitalizimit si një nga opsionet në setin e metodave të reformatimit reflektonte gjithashtu progresin në zhvillimin e standardeve të ruajtjes.

Debati mbi digjitalizimin për ruajtje është zhvendosur kohët e fundit nga theksi mbi reformatimin në çështjet e dobisë, cilësinë e dokumenteve të ruajtura dhe krizën në ruajtjen e fondeve të rrezikuara nga shkatërrimi fizik i dokumenteve origjinale siç është rasti me fondin “Gjyqi i Qarkut në Prizren”. Paul Conway shqyrtoi konceptin e ruajtjes dhe bëri një dallim të qartë midis digjitalizimit për ruajtje dhe ruajtjen digjitale. Ai përcaktoi digjitalizimin për ruajtje si “aktivitete që rezultojnë në krijimin e produkteve digjitale të denjë për ruajtje afatgjatë”, ndërsa ruajtja digjitale kuptohet si një grup politikash dhe teknologjish që synojnë mbrojtjen e vlerave të objekteve të krijuara si rezultat i digjitalizimit si dhe ato që lindin në formatin digjital.<sup>8</sup> Aktivitetet që lidhen me digjitalizimin për ruajtje përfshijnë jo vetëm procesin e konvertimit, por edhe përzgjedhjen, krijimin e një përshkrimi të plotë dhe të saktë digjital. Asetet digjitale të vlefshme për ruajtjen

digjitale duhet të përbëhen nga skedarë master digjital me cilësi të lartë dhe vlera intelektuale shtesë.

### **Projekti i digjitalizimit: Ruajtja dhe ndarja e dosjeve te fondit**

Qëllimi primar i projektit është ruajtja e informacioneve që bartin dokumentet e Fondit “Gjyqi i Qarkut në Prizren”, për të siguruar qasje në këto dokumente dhe për të siguruar ruajtjen afatgjatë të përfaqësimit të fondit në formë digjitale. Projekti u ndërtua në përvojën e mëparshme të stafit arkivor në digjitalizim, njohuritë e fituara nga studimi paraprak i fondeve dhe koleksioneve të realizuara si projekte apo pilot projekte të suksesshme. Projekte të digjitalizimit të realizuara më herët ishin si një abetare e shkëlqyer për ngritjen e një sistemi për të trajtuar në mënyrë të sigurt dhe për të digjitalizuar e ruajtur dokumentet e fondit në fjalë në mënyrë afatgjate. Fokusi primar i projektit është digjitalizimi për ruajtje i të gjitha dokumenteve të Fondit “Gjyqi i Qarkut në Prizren”. Projekti përfshin një numër aktivitete që synojnë ruajtjen dhe sigurimin e qasjes, duke përfshirë:

- Identifikimin dhe indeksimin e dosjeve;
- Përgatitjen e dokumenteve për skanim;
- Riformatimin digjital me krijimin e dosjeve të arkivit master për ruajtjen afatgjatë dhe imazhet derivative për qasje;
- Krijimin e meta të dhënave (metadatave) në nivel të dosjeve për të gjitha objektet e digjitalizuara;
- Integrimi i imazheve të zgjedhura me meta të dhëna në koleksione digjitale për ofrimin on-line;
- Paketimi dhe vendosja e dosjeve origjinale në fashikuj për ruajtje në depo;
- Transferimi i skedarëve master në arkivin digjital për ruajtjen afatgjatë;

dhe

- Dokumentimin e projektit.

### **Riformatimi digjital**

Qëllimi i riformatimit digjital është për të kapur përmbajtjen vizuale të dokumenteve dhe për të krijuar përfaqësime të sakta digjitale të materialeve origjinale. Udhëzimet për projektin u bazuan në standardet mbi arkivat digjitale

dhe praktikat më të mira për të siguruar një nivel të qëndrueshëm të cilësisë së imazhit dhe për të krijuar objekte digjitale me cilësi të lartë në mbështetje të përdorimit aktual dhe të ardhshëm. Dosjet master digjitale u krijuan si rezultat i drejtpërdrejtë i kapjes së imazhit gjatë procesit të skanimit.

Specifikimet teknike të skanimit u bazuan në formatin dhe karakteristikat e dokumenteve burimorë. Sfidat e para në procesin e skanimit u paraqitën gjatë procesit të përzgjedhjes së metodës për skanim të dokumenteve. Mungesa e materialeve për testim të skanerëve shkaktoi një kokëçarje të madhe në ekipin e digjitalizimit. Për shkak të brishtësisë dhe gjendjes jashtëzakonisht të keqe të dokumenteve burimore skanimi me skaner flatbed është i pamundur. Shih për këtë u vendos që skanimi i dokumenteve të fondit Gjyqi i Qarkut në Prizren të bëhet me skaner të ashtuquajtur owerhead. Agjencia Shtetërore e Arkivave posedon dy skaner të tillë, mirëpo për fondin në fjalë ekipi në digjitalizim përdorë FUJITSU ImageScannerScanSnap SV600 për shkaqe të shpejtësisë dhe përdorimit të lehtë.

Të gjitha skanimet rishikohen për cilësinë dhe ruhen si skedarë TIFF të pakompresuar dhe JPEG. Ato shërbejnë si kopje të ruajtjes dhe si burime për imazhet derivative. Të dy dosjet master digjitale dhe kopjet e shërbimit transferohen në depo digjitale në server për ruajtje afatgjatë.

### **Krijimi i meta të dhënave përshkruese në nivelin e dosjes**

Krijimi i metadatavepërfaqëson një pjesë të rëndësishme të projektit të digjitalizimit dhe ndërmerret për të siguruar pikat e hyrjes për imazhet e digjitalizuara dhe për të zgjeruar dobinë e tyre si burime informacioni. Të dhënat e meta të dhënave janë krijuar në dy nivele:

- Meta të dhënat minimale të elementeve që regjistrohen për të gjitha dosjet.
- Meta të dhënat përshkruese të gjera që mendohet për imazhet e përzgjedhura për prezantim online.

Metadat minimalë janë regjistruar për të gjitha dosjet digjitalizuara duke iu përmbajtur emrave origjinale dhe shënimeve përshkruese ekzistuese në dosje. Të dhënat u futën në bazën e të dhënave të ruajtura në nivel lokal. Strukturat e meta të dhënave për koleksionet digjitale të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës bazohen në një skemë të kualifikuar Dublin Core. Krijimi i metadatavepërfaqëson aspektin më sfidues të projektit për shkak të mungesës

së përshkrimit të materialeve burimore origjinale. Ekipi i digjitalizimit është ai që krijon meta të dhënat e fondit Gjyqi i Qarkut në Prizren.

### **Mësimet e nxjerra**

Ekipi i projektit ka përvojë të konsiderueshme paraprake në digjitalizim dhe ka drejtuar disa pilot projekte të suksesshme, megjithatë, ky projekt u tregua i ndërlikuar dhe sfidues. Kompleksiteti i parë ishte shkalla e projektit si në madhësinë dhe numrin e fashikujve respektivisht dosjeve të përfshira që janë në rrezik të shkatërrimit, po ashtu edhe në mungesën e përpunimit të dosjeve origjinale. Vështirësi tjetër është skanimi i dokumenteve veçse të shkatërruara, sidomos atyre të mbushura me myk, të cilat ekipin në digjitalizim e rrezikojnë drejtpërdrejt edhe në shëndet.

Një nga mësimet tona të para të nxjerra në proces është vlera e të pasurit një fond që është i indeksuar dhe që posedon informata kontekstuale. Në studimin tonë shtimi i rreth 4,000 dokumenteve digjitale në muaj për t'u përshkruar ka një ndikim të thellë në rrjedhat e punës së projektit. Ne vendosëm të bëjmë numër të madh të skanimeve për të përfunduar digjitalizimin dhe ruajtjen e të gjitha dokumenteve që janë në shkatërrim e sipër. Kjo nënkupton që në këtë projekt duhet të sakrifikojmë krijimin e meta të dhënave për disa dosje. Ne kemi përzgjedhur më pak dosje për metadata të plota dhe paraqitje në internet nga fondi Gjyqi i Qarkut në Prizren se sa që kishim planifikuar, dhe nenganjëherë duhet të shtyjmë krijimin e meta të dhënave për dosje të caktuara.

Mësimi i dytë është rëndësia e stafit profesional adekuat për një projekt të ndjeshëm siç është fondi Gjyqi i Qarkut në Prizren. Kur Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës formuloi projektin për digjitalizim të fondit në fjalë u planifikua që të bëhet nga një ekip i jashtëm nën mbikëqyrje të stafit të brendshëm. Fakti që ne ishim duke skanuar në ambientet e Agjencisë, na lejoi që të krahasonim kohën, burimet, cilësinë dhe gabimet midis skanimit jashtë objektit dhe skanimit në objektin e Agjencisë. Në fund, ne kemi gjetur se outsourcing merrte më shumë kohë se që kishim parashikuar për një numër arsyesh. Koha e kaluar e paketimit, transportimit dhe më pas e rishikimit të cilësisë së produkteve të skanuara - dhe në shumicën e rasteve brishtësia e dokumenteve mbështeti fuqishëm vendimin tonë për të skanuar fondin e

përzgjedhur brenda ambienteve të agjencisë. Në studimin tonë të rastit, skanimi në ambientet e agjencisë i fondit në fjalë kursen kohë për përgatitjen e dokumenteve, siguron skanime me cilësi të lartë dhe zvogëlon shkallën e gabimit në krijimin e dosjeve digjitale.

Leksioni i fundit i nxjerrë është mungesa e indeksimit gjithëpërfshirës dhe informatave kontekstuale të dosjeve të fondit gjë e cila po ngadalëson proceset e punës. Gjithashtu krijimi i metadatave nga ekipi në digjitalizim shkakton procese shtesë të punëve në digjitalizim të këtij fondi dhe si rezultat është numri më i vogël i dokumenteve të skanuara.

## **Përfundim**

Artikulli shqyrtoi çështjet e ruajtjes dhe qasjes së fondit Gjyqi i Qarkut ne Prizren dhe përdorimit të digjitalizimit për kapjen e përmbajtjes së dokumenteve te rrezikuara deri ne shkatërrim/asgjësim. Ai mbështet pikëpamjen se ruajtja jo vetëm që mbron lëndët e shkatërruara arkivore, por gjithashtu e rikthen dobinë e tyre si burime informacioni. Ne diskutuam konceptin e digjitalizimit për ruajtje në dritën e një projekti të shkallëzuar të digjitalizimit që synon ruajtjen dhe sigurimin e qasjes në mbi 80 metra gjatësi lineare te fondit Gjyqi i Qarkut ne Prizren e qe ruhet ne depo te arkivit .

Artikulli kontribuon në debatin mbi digjitalizimin për ruajtje duke eksploruar mënyrat në të cilat digjitalizimi sjell në vëmendje të ripërtërirë në ruajtjen e koleksioneve dhe fondeve të rrezikuara nga shkatërrimi. Rasti i digjitalizimit të fondit Gjyqi i Qarkut në Prizren demonstroi se digjitalizimi mundëson kapjen dhe ruajtjen e përmbajtjes së dokumenteve të cilat kanë kaluar përtej shërimit apo restaurimit. Përveç kësaj, digjitalizimi kontribuon në rikthimin e dobisë së fondit duke siguruar pikat hyrëse të qëndrueshme dhe duke i bërë ato në dispozicion edhe në internet. Është shumë shpejt për të parë ndikimin e plotë të këtij projekti. Megjithatë, kërkimi i shpejtë në dosje dhe gjetja e dokumenteve është treguesi më i mirë i suksesit të digjitalizimit të këtij projekti.

Qëllimet e qasjes dhe ruajtjes janë të lidhura ngushtë në digjitalizimin e fondeve apo koleksioneve të rrezikuara nga shkatërrimi. Digjitalizimi është një strategji e qëndrueshme për ruajtjen e fondeve dhe koleksioneve të çdo madhësie dhe kushtesh dhe është veçanërisht e rëndësishme nëse materialet origjinale

janë të brishta, të dëmtuara dhe të regjistruara në formate të paqëndrueshme. Digjitalizimi duhet të jetë pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse për qasje dhe ruajtje që siguron krijimin e dosjeve digjitale të kualitetit të lartë, zgjeron dobinë e objekteve të digjitalizuara duke dhënë përshkrime të plota dhe të sakta dhe adreson qëndrueshmërinë dhe ruajtjen afatgjatë të formateve digjitale.

- 
- 1 Smith, Abby: *Why Digitize?*, Washington, D.C.: Council on Library and Information Resources, 1999, fq. 6.
  - 2 Gertz, Janet: "Preservation and Selection for Digitization", Northeast Document Conservation Center, 2007.
  - 3 Oya Y. Rieger, *Preservation in the Age of Large-Scale Digitization: A White Paper*, no. 141 (Washington, D.C.: Council on Library and Information Resources, 2008), 1–4.
  - 4 National Information Standards Organization, *A Framework of Guidance for Building Good Digital Collections*, 3rd ed. (December 2007), 25–35.
  - 5 Kenneth Thibodeau, "Wrestling with Shaper-Shifters: Perspectives on Preserving Memory in the Digital Age," *Proceedings of the Memory of the World in the Digital Age: Digitization and Perseveration*, ed. Luciana Duranti and Elizabeth Shaffer (UNESCO, 2012), 15–23.
  - 6 Kathleen Arthur et al., for the Association of Research Libraries, "Recognizing Digitization as a Preservation Reformatting Method," *Microform and Imaging Review* 33, no. 4 (2004).
  - 7 Andrew Hart, "A Critique of 'Recognizing Digitization as a Preservation Reformatting Method'," *Microform and Imaging Review* 33, no. 4 (2004): 187.
  - 8 Paul Conway, "Preservation in the Age of Google: Digitization, Digital Preservation, and Dilemmas," *Library Quarterly* 80 (2010): 64–65.

## **BIBLIOGRAFI:**

- Arthur, Kathleen et al., for the Association of Research Libraries: "Recognizing Digitization as a Preservation Reformatting Method," *Microform and Imaging Review* 33, no. 4 (2004).
- Conway, Paul: "Preservation in the Age of Google: Digitization, Digital Preservation, and Dilemmas," *Library Quarterly* 80 (2010): 64–65.
- Gertz, Janet: "Preservation and Selection for Digitization", *Northeast Document Conservation Center*, 2007.
- Hart, Andrew: "A Critique of 'Recognizing Digitization as a Preservation Reformatting Method'," *Microform and Imaging Review* 33, no. 4 (2004). *National Information Standards Organization, A Framework of Guidance for Building Good Digital Collections*, 3rd ed. (December 2007).
- Rieger, Oya Y.: *Preservation in the Age of Large-Scale Digitization: A White Paper*, no. 141, Washington, D.C.: Council on Library and Information Resources, 2008.
- Smith, Abby: *Why Digitize?*, Washington, D.C.: Council on Library and Information Resources, 1999.
- Thibodeau, Kenneth: "Wrestling with Shaper-Shifters: Perspectives on Preserving Memory in the Digital Age," Proceedings of the *Memory of the World in the Digital Age: Digitization and Perseveration*, ed. Luciana Duranti and Elizabeth Shaffer, UNESCO, 2012.